

VENDIM
Nr. 51, datë 22.1.2025

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR PUBLIK, NDRYSHIMIN E KATEGORISË SË PËRDORIMIT DHE PAKËSIMIN NË VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 2.09 HA NË EKONOMINË PYJORE “ZARANIKË”, TË BASHKISË ELBASAN, PËR NDËRTIMIN E RRUGËS “GJERGJ ARIANITI” NGA BASHKIA ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen nga fondi pyjor publik, ndryshimin e kategorisë së përdorimit dhe pakësimin në volum të një sipërfaqeje prej 2.09 (dy pikë zero nëntë) ha, pjesë e ngastrave nr. 124a dhe 124c, të ekonomisë pyjore “Zaranikë”, që do të përdoret nga Bashkia Elbasan, për realizimin e projektzbatimit të rrugës “Gjergj Arianiti”, sipas lejes së zhvillimit, të miratuar nga Bashkia Elbasan, me nr. 3991/1, datë 25.10.2024, listës së ngastrave, të paraqitura në lidhjen nr. 1, si dhe plan-vendosjes me koordinatat përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Struktura përgjegjëse për pyjet në Bashkinë Elbasan ka detyrimin:

a) të shënojë në terren poligonin me sipërfaqen pyjore, objekt i ndërtimit, e cila hiqet nga fondi pyjor publik;

b) të bëjë vlerësimet për pasuritë e tjera pyjore, që hiqen gjatë kryerjes së punimeve dhe të mbajë aktet përkatëse;

c) të monitorojë rehabilitimin e sipërfaqes pyjore, objekt ndërtimi, sipas planit të rehabilitimit dhe vlerësimit të ndikimit në mjedis paraparak.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Bashkia Elbasan ka detyrimin të rehabilitojë sipërfaqen dhe të pyllëzojë me fondet e veta një sipërfaqe prej 4.44 (katër pikë dyzet e katër) ha në ngastrat e përcaktuara nga struktura e menaxhimit të pyjeve të bashkisë ose të paguajë paraprakisht kostot e përlllogaritura për pyllëzimin kompensues përkatës, si rezultat i ndryshimit të destinacionit të përdorimit të fondit pyjor, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Bashkia Elbasan kryen pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan veprimet për regjistrimin e sipërfaqes së hequr nga fondi pyjor publik, sipas parashikimeve të këtij vendimi, nga kategoria “pyll”, dhe e regjistron në kategorinë e re përkatëse të përdorimit, në pronësi publike.

5. Bashkia Elbasan bën ndryshimet në regjistrin kadastral të fondit pyjor për sipërfaqet, objekt i ndërtimit të rrugës, në përputhje me kërkesat e vendimit nr. 171, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e bazës së të dhënave për Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe Regjistrin e Fondit Kullosor, përcaktimin e strukturës, kriterëve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”.

6. Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan bën ndryshimin e kategorisë së përdorimit në të dhënat e regjistrit kadastral për sipërfaqen e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

7. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia Elbasan, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Bashkia Elbasan

Nr.	ID e pronës	Ekonomia pyjore/kullosore	Ngastran/ngastra	Sipërfaqja që hiqet nga fondi pyjor <i>ha</i>	Kategoria përdorimit
1	2	3	4	5	6
1	EL70 00 0124a	Zaranikë	124a	1.175	Trungishte
2	EL70 00 0124c	Zaranikë	124c	0.9150	Tokë me bimësi pyjore
				2.09	

PLAN-VENDOSJA E NGASTRAVE PYJORE QË HIQEN NGA FONDI PYJOR

